



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
OSNOVNI SUD U PRIZRENU – BASIC COURT OF PRIZREN

AD-GJTHPZ.nr.6/22

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, kryetarja e gjykatës, Shpresa Emra, duke vepruar sipas detyrës zyrtare në bazë të shkrimeve-deklarimit të E.Q., nga fsh., Komuna e Dragashit, ndaj gjyqtarit të kësaj Gjykate, F.K., në bazë të së cilës është bërë iniciimi i procedurës disiplinore, me dt. 12.07.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohen si të pabazuara deklaratimet e E.Q., nga fsh., Komuna e Dragashit, ndaj gjyqtarit të kësaj Gjykate, F.K., për iniciimin e procedurës disiplinore.

A r s y e t i m

Parashtruesi i shkrimeve—deklarimit E.Q., nga fsh., Komuna e Dragashit, është ankuar dhe ka komentuar ndaj gjyqtarit të kësaj Gjykate, F.K., në faqen e rrjeteve sociale "Facebook" të emisionit Betimi për Drejtësi ku ka cekur se "aktgjykimet i len për pazare, nëse vonohen nuk janë të rastësishme, po ato bëhen për shantazhe, hiq më larg më ka ndodhur mua ku gjyqtari ka kërkue lek për me mundësu me i thirë dëshmitarët " fjala ka qenë për gjyqtarin e Gjykatës Themelore në Prizren F.K.,.

Kryetarja e gjykatës pasi që ka vërejtur këtë shkrim, sipas detyrës zyrtare ka iniciuar hetimet për procedure disiplinore dhe ka ndërmarrë disa veprime në këtë drejtim. Fillimisht ka bërë shqimin në shkresat e lëndës, ka kërkuar deklaratë nga gjyqtari i çështjes ka verifikuar nëse ka ankesë ndaj vendimit të gjyqtarit të lartcekur dhe nëse janë kryer të gjitha veprimet adekuate për vazhdim të procedurës sipas ankesë. Pasi ka analizuar pretendimet ankimore, ka konstatuar se:

Ankesa është e pabazuar.

Është vlerësim te kryetarja e gjykatës se në rastin konkret gjyqtarit i çështjes ka vepruar në kuadër të autorizimeve ligjore, i njëjti është i pavarur në punën e tij dhe vendos në bazë të provave dhe ligjeve në fuqi dhe se gabimet eventuale të tij i korrigjon në bazë të ankesës shkalla e dytë respektivisht Gjykata e Apelit.

Pretendimet dhe shkrimet në rrjetet sociale duhet të jenë të dokumentuara dhe të vërtetuara në mënyrë që të jenë bazë për iniciim dhe aprovim të ndonjë procedure disiplinore ndaj gjykatësit. Gjykatësi ka qenë i ngarkuar me lëndën penale ku si i akuzuar ka qenë E.Q., dhe i njëjti ka

përfunduar këtë rast. I akuzuari pas përfundimit të gjykimit dhe pranimit të aktgjykimit në afatin ligjor ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit si shkallë të dytë e cila është kompetente për vlerësimin e vendimit të të gjyqtarit.

Kryetarja ka vlerësuar se në rastin konkretë nuk ka pasur zvarritje të qëllimshme të procedurës, por për shkaqe më tepër objektive nuk ka qenë e mundur që deri më tani të përfundohet rasti në tërësi pasi që i akuzuari ka shfrytëzuar të drejtën e tij për përjashtim të organit gjykues, për kundërshtim dhe të drejta tjera gjatë procedurës së gjykimit.

Gjithashtu në rastin konkret është e vërtetë që gjyqtari ka refuzuar propozimin e të akuzuarit E.Q., për dëgjim të dëshmitarëve në shqyrtim, por kjo është çështje procedurale dhe nuk ka ndonjë indice për kushtëzim për aprovim të këtij këtë propozimi dhe për këtë mund të parashtrohet ankesë në shkallë të dytë për shkelje procedurale, gjë që edhe ka bërë i akuzuari dhe tani lënda është me ankesë në Gjykatën e Apelit.

Për arsyet që u cekura më lartë, është vendosur si në dispozitiv të aktvendimit në kuptim të nenit 9 paragrafi 6 lidhur me nenin 17 paragrafi 5 të Ligjit nr.06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

AD-GJTHPZ.nr.6/22, me dt. 12.07.2022

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prizren

Shpresa Emra

ë e drejta e ankesës.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e paraparë e drejta e ankesës.